



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:157928
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05688430

C.nr.2594/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shyqri Hoxha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.E. nga fshati Piranë, Komuna e Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Av.Xh.E. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimëve "Siguria", për çështjen juridike me objekt kontesti padi për kompenzim dëmi, vlera e kontestit 2,500.00 euro, jashtë seancës gjyqësore të mbajtur me datë 15 maj 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia e paraqitur me datë 03.08.202, e regjistruar nën numrin C.nr.2594/22, e paditësit A.E. nga fshati Piranë Komuna e Prizrenit, kundër të paditurit Kompania e Sigurimëve "Siguria", për çështjen juridike, me objekt padi për kompenzim dëmi, vlera e kontestit 2,500.00 euro .

A r s y e t i m

Paditësi A.E. nga fshati Piranë Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tij Xh.E. me datën 03.08.2022, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, kundër të paditurit Kompania e Sigurimëve "Siguria" për çështjen juridike me objekt kontesti padi për kompenzim dëmi, vlera e kontestit 2,500.00 euro.

Ndërsa me datë 14.05.2024 përmes parashtrësës pranë kësaj gjykate nga ana e paditësit A.E. nga fshati Piranë Komuna e Prizrenit, kundër palës së paditur Kompania e Sigurimëve "Siguria" e ka njoftuar gjykatën se e bëne tërheqjen e padisë me nr. C.nr.2594/2022.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2594/2022, datë 15 maj 2024

Gjyqtari
Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.